



**VENDIM**

**Nr. 45 Datë 02.05.2012**

**PËR**

**FILLIMIN E PROCEDURAVE TË SHQYRTIMIT TË APLIKIMIT  
TË SHOQËRISË “HENZ ENERGY” SH.P.K PËR KUALIFIKIMIN E  
IMPIANTEVE PRODHUESE NGA HEC-ET “DARSI 1”, “DARSI 2”  
DHE “DARSI 3” SI BURIME TË RINOVUESHME ENERGJIE**

Në mbështetje të neneve 8 pika 2, gërma “l”, 9 dhe 39 të Ligjit Nr. 9072, datë 22.05.2003 “Për Sektorin e Energjisë Elektrike” të ndryshuar, nenit 18 pika 1 germa “d”, të Rregullave të Praktikës dhe Procedurave të ERE-s të miratuara me Vendimin e Bordit të Komisionerëve Nr. 21 datë 18.03.2009, te ndryshuar, dhe neneve 6, 7 dhe 8 të Rregullave dhe Procedurave të Çertifikimit të Prodhimit të Energjisë Elektrike nga Burimet e Rinovueshme të miratuara me Vendimin e Bordit të Komisionerëve Nr. 9, datë 21.02.2007, Bordi i Komisionerëve, në mbledhjen e tij të datës 02.05.2012, pasi shqyrtoi aplikimin e paraqitur nga shoqëria “Henz Energy” sh.p.k për kualifikimin e impiantit prodhues për HEC-et “Darsi 1”, “Darsi 2” dhe “Darsi 3” si burim i rinovueshëm energjie,

**Konstatoi se:**

Aplikimi i paraqitur nga shoqëria “Henz Energy” sh.p.k, është konform Rregullave dhe Procedurave të Çertifikimit të Prodhimit të Energjisë Elektrike nga Burimet e Rinovueshme si më poshtë:

- **Neni 7, pika 1, gërmat “a”, “b”, “c”, “d”**  
Përshkrimi i përgjithshëm i centralit.  
Ky dokumentacion është dhënë i sakte dhe i plote.
- **Neni 7, pika 2, gërmat “a”, “b”, “c”, “d”**  
Dokumentacioni vijues grafik, koreografia, planimetria e përgjithshme, skema funksionale etj.  
Ky dokumentacion është paraqitur ne mënyrë korrekte.
- **Neni 7 pika 3, gërmat “a”, “b”, “c”**  
Përshkrimi i centralit...  
Ky dokumentacion është dhënë i sakte dhe i plote.

Për gjithë sa më sipër cituar, Bordi i Komisionerëve të ERE-s,

**VENDOSI :**

1. Të fillojë procedurat për shqyrtimin e aplikimit të shoqërisë “Henz Energy” sh.p.k, për kualifikimin e impianteve prodhuese nga HEC-et “Darsi 1”, “Darsi 2” dhe “Darsi 3” si burime të rinovueshme energjie.
2. Ngarkohet Drejtoria e Liçensimit dhe Monitorimit të Tregut të njoftojë aplikuesin lidhur me Vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.